

VENDIM
Nr. 1063, datë 23.12.2015

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “MBI EMETIMIN E ZHURMAVE NË
AMBIENT NGA PAJISJET PËR PËRDORIM NË MJEDISE TË HAPURA”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 2, dhe 42, të ligjit nr.10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekono-mik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullit teknik “Mbi emetimin e zhurmave në ambient nga pajisjet për përdorim në mjedise të hapura”, sipas tekstit bashkëlidhur, që është pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekono-mik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrín efektet e zbatimit të tij nga data 1.1.2016.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

¹ Direktiva 2000/14/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 8 maj 2000, “Mbi emetimin e zhurmave në ambient nga pajisjet për përdorim në mjedise të hapura”.